

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve L. B. nga Gjakova për shkak të veprës penale të vjedhjes së rënd nga neni 327 par.1 nen par. 1.1të KPRK-ës, dhe e T. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.526/15 të datës 05.05.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **11.05.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu të dëmtuarve Y. L., D. B, si dhe të, akuzuarve, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **L. B.**, nga Gjakova, i biri i N. dhe i H. e gjinisë B, data e lindjes..., ne Gjakovë, ka te kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **T. M.**, nga Gjakova, i biri i Xh. dhe i nenës M. e gjinisë D., data e lindjes..., ka te kryer shkollën e mesëm, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar at i 1 fëmijë, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

### Ë s h t ë f a j t o r

I akuzuari L. B.

#### Sepse:

#### I.

-me dt. **07.01.2014 ne ora 10:00**, ne Gjakovë ,ne rrugën ..., përkatësisht ne lokalin “E. D.”, i cili gjendet ne afërsi te semaforëve ne qendër te qytetit, ne menaxhim te Y. L. dhe D. B. nga Gjakova, me qellim te përvetësimit pasuror te kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, tjetrit ia merr pasurin e luajtshme ne atë mënyrë qe i pandehuri duke përdorur forcën hap derën e lokalit, hynë brenda dhe nga aty ka vjedhur ne TV”Plazma” e llojit “Telefunken”, me ngjyre te zezë ne vlere prej 500 euro, një telefon te tipit “Nokia” ne vlere prej 150 euro, si dhe 25 kg. pleskavica ne vlere prej 350 euro, me pas largohet nga vendi i ngjarjes ne drejtim te panjohur .

**-me çka ka kryer vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1nen par.1.1 te KPRK-së**

I akuzuari **T. M.**

#### Sepse:

#### II.

- me datën e pavërtetuar ne Gjakovë, saktësisht tek lokali “F.” i cili gjendet përball Prokurorisë Themelore, nga i pandehuri L. B. blen 2(dy) televizor te llojit “Plazma”, njëri i markës “Telefunken” model TK42x917 dhe markës “Panasonic” model TH-42PA20, qe te dy me ngjyre te zeze për shumen e te hollave prej 250 euro (dyqind e pesëdhjetë ) euro edhe pse i pandehuri ka mund te këtë ditur se televizorët ishin siguruar si rezultat i kryerjes së veprës penale te vjedhjes , pasi qe kundërvlera e televizorëve te blerë është dukshëm me e ultë se sa vlere e tyre ne çmimin e tregut , te cilat janë siguruar si rezultat i veprës penale te vjedhjes se rende nga lokali “E. D.”, ne menaxhim te Y. L. dhe D. B..

**-me këtë ka kryer veprën penale blerja , pranimit ose fshehja e sendeve te përfituara me kryerjen e ve pres penale nga neni 345 par. 2 te KPRK-ës.**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,41,45, 46,49,50,51 ,73,74,75,76 dhe nenit 327/1 nen par 1.1 si neni 345/2 të KPRK-së, dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarve iu shqipton :

### **DËNIM ME BURG**

Të akuzuarit **L. B.**, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **1 (një) viti** si dhe dënimin me gjobë ne shume prej 300(treqind ) euro, të cilën dënim është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 ditësh ) pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas neni 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 (njëzet).-€**

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe atë ne emër te paushallit gjyqësorë shumën prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit **T. M.**, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afati prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet I akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30 ,00 €**, në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP-nr.526/15 të dt. 05.05.2016, ka akuzuar të akuzuarit L. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327par.1 nen par 1.1 dhe T. M. nga Gjakova për shkak të veprës penale te blerjes ,pranimit apo fshehja e sendeve te përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345/2 të KPRK-së, duke propozuar qe të akuzuari të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 11.05.2017, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Bajram Kryeziu lexoi aktakuzën PP.nr.536/15 të dt. 05.05.2016, mbeti ne tërësi pranë aktakuzës. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit e qe u be i lirshëm e i vullnetshëm duke i kuptuar pasojat u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lendes ka edhe prova tjera bindëse se kanë kryer veprat penale për te cilat akuzohen sipas aktakuzës PP.nr. 526/15 te dt. 05.05.2016, e gjykatës i propozoi qe te njëjtit të shpallen fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale, te dënohen sipas ligjit dhe ta detyrohen ne pagesën e shpenzimeve te procedurës.

I dëmtuari D. B. ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qene se gjësendet e vjedhura na janë kthyer.

I dëmtuari Y. L., ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qene se gjësendet e vjedhura na janë kthyer .

I akuzuari L. B., gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion. Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, kërkojë falje nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,pendimin e shprehur ne gjykatë, kërkim falja nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar ,gjendja e varfër ekonomike si dhe gjendja ime e rende shëndetësore si invalid te me shqiptojë një dënim sa me te butë.

I akuzuari T. M., gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion. Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer duke mos e ditur se gjësendet janë të vjedhura, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm, kërkojë falje nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar , andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,pendimin e shprehur ne gjykatë, kërkim falja nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar, gjendja e varfër ekonomike te me shqiptojë një dënim sa me te butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprat penale që iu vihen në barrë dhe janë bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ky pranim është bërë i pakushtëzuar dhe vullnetarisht Gjykata ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me faktet e ofruara ,provat që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, sidomos pranimi i fajësisë, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ,andaj me veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet e veprave penale vjedhje e rende nga neni 327/1 nen par1.1 dhe veprës penale blerje, pranimi ose fshehje e sendeve te përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par 2 të KPRK-së për të cilat vepra të akuzuarit janë penalisht përgjegjës dhe janë ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjatë marrjes se vendimit mbi dënimin kundër te akuzuarve dhe llojit te tij ,gjykata vlerësojë te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese te parapara nga neni 74 te KPRK-ës, te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit .Gjykata nuk ka gjetur rrethana posaçërisht renduese përpos qe ka konstatuar qe ndaj te akuzuarit L. B. janë duke u zhvilluar procedura penale për vepra penale sipas lendeve P.nr. 116/17,PKR.nr.47/17, ndërsa si rrethana lehtësuese ka marr parasysh sjelljen e mire te akuzuarit gjatës shqyrtimit gjyqësor ,pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur në gjykatë dhe kërkim falja nga të dëmtuarit ,gjendjen e varfër ekonomike dhe gjendjen e tij shëndetësore, deklarata e te dëmtuarve se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kërkojnë kompensim demi me qe gjësendet e vjedhura iu janë kthyer, e te cilat rrethana ndikuan qe gjykata duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes se kësaj vepre penale, rrezikshmërinë e saj dhe personalitetin e te akuzuarit ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit nga neni 76 te KPRK-ës dhe te akuzuarit L. B. i ka shqiptuar dënimin nen minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënimin me gjobë ne shume prej 300(treqind) euro, ndërsa për te akuzuarin T. M., Gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimi i fajësisë ne çdo fazë te procedurës, sjellja korrekte ne gjykim, gjendja e varfër ekonomike, pendimin e shprehur ne gjykate dhe kërkim faljen nga te dëmtuarit si dhe faktin se me pare nuk ka qene i dënuar , te njëjtit komform nenit 73 te KPRK-ës i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3(tre) muajve

i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se dënim është në harmoni me peshën e veprave penale ,shkallen e përgjegjësive penale të akuzuarve dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u murr konform neni 463 të KPPK-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet në dispozitën e neni 450 par.1 dhe 2 nën par.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.250/16 më datë 11.05.2017.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.